



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.260/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar, ankesa e Instituti Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë Anr.260/2025 datë 30.01.2025.

II. Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,500.00 Euro (dhjetëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 30.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 29 janar 2025 në orën 17:00, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje mbajti një tubim elektorale me gratë dhe vajzat e Kosovës në sallën 1 tetori në Prishtinë, gjatë këtij tubimi, kandidati për deputet nga subjekti politik Albin Kurti, ka përdorur gjuhë urrejtëse ndaj kundërshtarëve të tij politik gjatë prezantimit të kandidates për deputete Mimoza Kusari Lila, duke theksuar dhe etiketuar këta kundërshtar si "burreca e

buburreca". Konkretisht, nga shiqimi dhe dëgjimi i disa videove të publikuar në edicionin e lajmeve të orës 20:00 të televizionit Klan Kosova(shih si në poshtë linkun e videos nga minuta 25 deri në 26.2 sekonda) si dhe nga publikimi i këtij fjalimi në rrjetin social të web faqes së subjektit politik Levizja Vetëvendosje (LVV) në Facebook, paraqitet në mënyrë të qartë theksimi i këtij epiteti që mund të konsiderohet si urrejtës.

Parashtruesi i ankesës thekson se gjatë një pjese të fjalimit kandidati për deputet Albin Kurti përdori gjuhë si në vijim: "...Në vitin e fundit Mimoza teksa po luftonte me kancerin, e në publik po sulmohej dëshpërimisht çdo ditë nga disa burra, burrecat, nga disa buburrecat të cilët me materiale të montuara e çmontuara e të rimontuara që ua kishin dhënë miqtë nga Lista Serbe..." Pra, nga ky fjalim vërehet qartë fakti se këto lloje epitetesh si burrecat e buburrecat përbëjnë shkelje të qartë të Ligjit nr. 08/1--228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11.

Kërkojnë nga PZAP-i, që këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar dhe njëherit të nxjerr vendim meritore me të cilin këtij subjekti politik LVV-së t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 31.01.2025, Lëvizja VETËVENDOSJE! vlerësojnë se ankesa është e pabazë dhe e paqëndrueshme, për faktin se e njëjta në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin deklaratën me shkeljen e pretenduar, dhe e cila, do të binte ndesh me nenin 34 të LVP-së paragrafi 1, nën paragrafi 1.11.

Më tej në përgjigje theksohet se, ankuesi pretendon se kryeministri Albin Kurti ka ofenduar dike, mirëpo nga provat e bashkangjitura vërehet se e njëjta nuk qëndron pasi që nuk është përmendur ndonjë person ndaj të cilit mund të jetë drejtuar gjuhë të papërshtatshme, sepse i njëjti me këto terme ka quajtur personat e pa përcaktuar dhe jo subjektet politike, të cilat shpesh herë kanë sulmuar znj. Mimoza Kusari Lila pa arsye dhe pa bazë, me qëllim denigrimin e figurës së saj. Pra kjo nuk është deklaratë e shprehur në drejtim të ndonjë subjekti politik dhe si e tillë nuk përbën Shkelje të ligjit zgjedhor ndërsa kufizimi i deklaramit do të përbënte në vete kufizim të shprehjes së lirë.

Andaj bazuar në të lartcekurat e kësaj përgjigje në ankesë dhe liritë e shprehjes së individëve, kërkojmë nga PZAP që ankesën A.nr.260/ 2025 të parashtruar nga KDI, të nxjerrë këtë:

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LVP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - video incizimit të ofruar si provë materiale, e cila është publikuar nga kandidati për kryeministër nga radhët e subjektit politik LVV, shihet se kandidati Albin Kurti nga ky subjekt ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj subjekteve tjera politike në garë, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit në tubimin "*me gratë dhe vajzat e Kosovës*" në sallën 1 Tetori në Prishtinë, me datë 29 janar 2025, ka përdorë fjalët "*Në vitin e fundit Mimoza teksa po luftonte me kancerin, e në publik po sulmohej dëshpërimisht çdo ditë nga disa burra,*

burreca, nga disa buburreca të cilët me materiale të montuara e çmontuara e të rimontuara që ua kishin dhënë miqtë nga Lista Serbe...", paneli vlerëson se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë nxit ose provokon, mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve dhe është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decidive thuhet se : *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*, e që sipas vlerësimit të panelit ky veprim është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Të lartcekura

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës dhe vlerësimit të provave, nga të cilat rrjedh se gjatë mbajtjes së fushatës politike, kandidati për kryeministër nga radhët subjektiv politik LVV, ka dhënë deklaratë e cila është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe se të njëjtit kanë përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit të tyre, vlerëson se është gjuhë denigruese, dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit për kryeministër nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së dhe rregullës zgjedhore 07/2024.

Sipas Panelit nga përmbajtja e deklaratës së kandidatit për kryeministër nga Subjekti Politik LVV, Albin Kurti, konsiderohet gjuhë nxitëse dhe urrejtëse *kundrejt të tjerëve* në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidati i lartcekur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektivit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e

Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.260/2025 më datë 01.02.2025

Kryesues i Panelit,

Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.